



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:101009

Datë: 07.03.2023

Numri i dokumentit: 04054427

**PKR.nr.95/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, gjyqtari Sami Sharaxhiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në çështjen penale ndaj të pandehurit N (D) K, nga fshati B., Komuna GJ., për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 i KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i për Krime të Rënda PP/L.nr.143/2022, të datës 23.05.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 06.03.2023, në prezencë të Prokurores së Shtetit Sahide Gashi, të pandehurit N.K dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare avokatit Burhan Shabanaj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa, me datë 07.03.2023 përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri :

**N. K.**, i lindur me datë ....., në fshatin B., Komuna GJ., ku edhe jeton, i biri D. dhe T., e gjinisë O., i martuar – baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme - gjimnazin, me profesion gastronom mirëpo, nuk punon për shkak se është invalid, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër të telefonit ... – ... – ..., i identifikuar me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

Me parë e gjerë me datë 25.04.2022, rreth orës 16:05 minuta, në rrugën “A.J”, Komuna P., i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit Për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pistoletë ..prodhim kinez, me numër serik ....., një karikator dhe tetë (8) copë fishek kal. 7.62 mm, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që Policia e Kosovës e kanë ndaluar veturën e llojit G. ., me targa ..-...-..., të cilën veturë e drejtonte i pandehuri N.K, policia gjatë kontrollit në brezin e të njëjtit kanë gjetur dhe sekuestruar armën dhe municionin me të dhënat e lartcekura,

- me çka ka kryer veprë penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8, 9, 17, 21, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70, neni 366 par.1 i KPRK-së si dhe nenet 358, 359, 360, 364 të KPPRK-së, të pandehurit N.Ki shqipton:

## **DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që të pandehurit N.K i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës një (1) viti nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzetepesë (25 €) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50 €) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, ndaj të pandehurit N.Kshqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI** dhe atë:

1. Një (1) Pistoletë ..prodhim kinez, me numër serik ....
2. Një (1) Karikator i të njëjtës armë dhe
3. Tetë (8) fishekë të gjallë cal.7.62 mm

të cilat urdhërohet që të shkatërrohen në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, duke u thirrur nen numrin e rastit policor të ... – ... -..., të datës 24.04.2022.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i për Krime të Rënda, ka ngrit Aktakuzën PP/L.nr.143/2022, të datës 23.05.2022, ndaj të pandehurit N (D) K, nga fshati B., Komuna GJ., për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 i KPRK-së.

Gjykata, fillimisht caktoj seancën fillestare me datë 19.01.2023, e cila u shtye për shkak se nuk ishte prezent i pandehuri dhe në shkresat e lëndës nuk kishte prova se është ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata caktoj dhe mbajti seancën fillestare me datë 06.03.2023, në prezencën e prokurorit të shtetit Sahide Gashi, të pandehurit N.Kdhe mbrojtësit të tij avokatit Burhan Shabanaj.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/L.nr.143/2022, të datës 23.05.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe të njejtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë me ç'rast i pandehuri N.K ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës dhe se e pranon fajësinë në baza vullnetare dhe i pandikuar nga askush dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë sa i përket të pandehurit i cili pranim fajësie është në harmoni me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe i

propozon gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoi, të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoi sipas ligjit dhe ta obligoi në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit avokati Burhan Shabanaj, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe ngase i njëjti pranim ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës i propozoi gjykatës që me aktvendim procedural ta aprovoi pranimin e fajësisë duke kërkuar që pranimi fajësisë në fazë të hershme të procedurës penale të merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese po ashtu, sjellja e tij e mirë dhe korrekte gjatë procedurës, fakti se i njëjti është invalid në shkallë 80 % dhe i njëjti nuk është i aftë për punë, e ka gjendjen e dobët ekonomike, fakti se nuk ka qenë asnjëherë i dënuar, duke pas parasysh faktin se edhe vet qëllimi i dënimit nuk është ndëshkimi.

Gjykata nuk e mbajti seancën për caktimin e dënimit pas pranimi të fajësisë e paraparë me nenin 356 të KPPRK-së meqë, mbrojtësi i të pandehurit N K, avokati Burhan Shabanaj, deklaroi se pas konsultimit me të mbrojturin e tij heqin dorë nga kjo seancë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 dhe 242 par.2 pika 2.1 deri 2.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave por, gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i Oficerit V D, i datës 25.04.2022, Raporti i Policit hetues A S, i datës 25.04.2022, Lista e Armëve të Konfiskuara, e datës 25.04.2022, Raporti i Policit Hetues S H, i datës 25.04.2022, Lista e Dëshmimeve, e datës 25.04.2022, Foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës, erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, pati sjellje korrekte dhe gjykata nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin ndërkaq, nga rrethanat rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së e obligoi të pandehurin në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Vendimi për kompensimin e të dëmtuarës u morr konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3 nënpar. 3.2 të Ligjit për Kompensim të Viktimave të Krimit e obligoi të pandehurin që të paguaj taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.95/22, me datë 07.03.2023**

**Kryetari i Trupit Gjykes  
Sami Sharaxhiu**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.